


BIBLIOTEKA

854-1

T 22

Lefter Tamo



Kaprolli martohet me sorkadhen e huaj

fabula dhe vjersha satirike

EBB
Enti Botues Berat

1995


SSH-1

T 22

Lefter Tamo

Kaprolli martohet me sorkadhen e huaj

fabula dhe vjersha satirike



EBB
Enti Botues Berat

1995

Kioskat

J. A. KOSOVË

I.

Përvojnë se në demokraci
Iniciativa e lirë
Ka përparësi.
Fillimisht në pyll
E treguan kioskat
Që mbushën sheshet dhe rrroskat:
Por erdhi një çast
Dhe lëndinat,
U mbuluan krejt vitrinat,
Nga tezgjat, thasët e rraqet
Atje ku kundërmonin
Manushaqet.

II.

U tha dalëngadalë gjithë pylli
Blerim më s' gjalloi aty:
Se dikush paguante nën dorë,
E dikush mbyllte një sy...

Qëndronin këtu, këtu
Kioskat, këtu
Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu.

Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu, këtu
Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu.

Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu, këtu
Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu.

Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu, këtu
Qëndronin këtu, këtu
Kioskat këtu.

Ankesa e gjinkallës

Në vjeshtë, kur i begatë
Ishte prodhimi
Me lizj u bë në pyll
Privatizimi.

Gjer natën mbi lëndina
S'rreshti vallja,
Ueç për çudi, pa pjesë
Mbeti gjinkalla.

- Nuk duhet që të qahesh, -
I tha një ketër,
- Në jetë ti fjalë prodhove
E asgjë tjetër.

Por llafazania
Shkurt fjalët i mbylli:
- Pse të punoja?
Ishte kohë qyli.

Pendimi i dhelprës “politikane”

Pasi i provoi
Të gjitha partitë
Dhe në karrierë
Dhelpëra dot s'u njiit.
Rrëmbeu një kolltuk
Në parlament
Ku më në fund u duk
Se zuri vend.
Por një mëngjes nga fundi
U ngrit dreri:
- Unë them të ndahet
Shapi nga sheqeri.
Se ka mjaft faqezinj
Politikanë
Që si die edhe sot
Hanë bakllavanë...

Ç'të shihet dhelpëra?
Salla s'pipëtiu.
Qenë struktur ujku, tigri
Dhe ariu:
Kujtoi gjithë ç'kish bërë
Fort u pendua
Dhe tha:
- Ç'më duhej politika mua?

Drejt Europës

Kur pyllit shtizjet iu hapën
Me botën nisi ecejakë.
Lindi parrulla: drejt Europës.
Përndryshe ngecëm në batac.

Të nxitura nga puna e lirë
Kafshët me mend zëjodhën biznesin
Të tierat, me drogë dhe rrëmbime
Peshqesh ia bënë pyllit vesin.

U ngrit më plakuri i kapronive:
- Or diem, një vërejtje ju bëj unë.
Të shkojmë me hap drejt Europës
Se me revan do të biemë në lumë!...

Diskutim në parlamentin e pyllit

1.

Kur u votua për ligjin

Mbi të drejtat kafshërore

Debatet morën zjarr në Parlament.

Të gjithë deputetët e trajtuan

Këtë problem nga këndvështrim i sert.

U ngrit ariu e bërtiti:

- Që të gëzojë të drejtat individi.

Pengojnë ekstremistë

Në ditët tona:

Si bëhet që bletët e parinovueshme,

Të na thumbojnë nga zgërbonjat?

- Ndërsa unë, - tha ujku,

Them të hiqen qentë e staneve

Dhe ndërkohë t'u jepet dhënye

Autonomia prej çobanëve.

2.

Natyrisht,

Të akuzuarit u mbrojtën

(Duke kërkuar dhe interpelancë)

Por në votim davanë e humbën

Se qenë mishngrënësit maxhorancë.

Urithi dhe serra

Ndanë lumit ku nuk kish veç toka djerrë
Një ditë urith kopshtari ngriti serra.

E çfarë s'prodhoi? Domate e kastraveca.
E mbushi tregun me shalqini e speca.

Por matanë lumit, ara fqinjë, përballë
E xhveshur kishte mbetur, krejt në hall.

Tha serra: - motër, ti, s'ke tokë të keqe
Përse nuk lulëzohe e nuk ndreqe?

Në vend të saj u djezj urith kopshtari:
- Asaj s'i ka dalë ende ishpronari.

Kanarina bëhet prostitutë

Kur udhët u hapën
Drejt pyjesh të tjera
Në derë, kanarinës,
I erdhën dy derra.

- Okej bukuroshe
Nga vendi lëviz.
A don që të bëhesh
Një yll ose mis?

Lër pas virgjërinë
Se është për të marrët.
Shijo koka - kolën
Dëfrimet, dollarët!

Matanë është paraisa
Ku s'venë dot të tjerë
U shtang e u verbua
Kanarina e mjerë:

Dhe drejt aventurës
Urapoi symbyllur
Nga ku do të kthehej
Limon krejt i shtrydhur.

Ariu refugjat

1.

Meqenëse në vendlindje

Pa bukë mberi i gjori.

Si refugjat ariu

Udhët e botës mori...

Më në fund u sos

Diku, në Etelikos.

Kaloi një efendiko i pasur

Që e pranoi pa fjalë

Dhe punës iu shtrua porsi kalë.

- Të lumtë arillos - tha pronari

- Të shkoka përsëmbari.

Ë shoh se qysh tani

Me ty do të më pjellë gjelhi flori.

Nga sot të rritet paga

Se s'je malaza.

Dhe vërtet rrogën ia shtroi.

Ariu nga gëzimi fluturoi.

2.

Por s'pati fat qyqari.


Njëherë ca bashkëqytetarë

Kaluan aty pari:

Thanë: - t'ja marrim paratë

Se s'paska hënë këtë natë.

Gjithkush ndër këto anë e di
Se ky ka bërë prokopi...
Dhe shkoi nata.
Sërishmi zbardhi dita.
Por më, ariu, s'doli nga korita!



Ujku në Bosnjë

1.

Diku midis Bosnjes
Së diegjur, gërmadhë.
Një ujë po çapitej
Ngadalë, si në përrallë.
Papritur një sërë
Të krekosur, ai pa
Dhe plot me kureshtje
Qëndroi e i tha:
- Kam kohë or njeri
Që këtej unë po endem.
Jam lodhur, cfilitur.
E sa nuk po çmendem:
Po rrotull, vëllezërit e mi.
S'i pashë dot,
Mos vallë ujku i fundit
Kam mbetur në botë?

2.

Tha sërbi: - e vërtetë.
S'gjen ujë në këto anë
Se ujku me njeriun
E humbi davanë.
S'kish parë se si vëllai
E vriste vëllanë
Dhe iku, se nga krimet
Iu nziethën qimet,
Në raport me ne, serbët

(Plotësisht i bindur)
Se jo uik por ëngjëll
Kishte lindur.



Gabimi i lepurit

1.

Nuk di një ditë, si lepuri guxoi
Luanin mbret në gjumë e pikturoi.

Meqënëse frymëzimi ish i rrallë
Edhe piktura dukej si e gjallë:

Ndaj kur u zgjua, u habit luani,
Porsi dy pika uji të dy ngrinin.

Dhe lepurit i foli: - përgëzime!
Qysh sot ti do të jesh nën mbrojtien time.

Askush s'do guxojë udhën ta presë
Ndërsa për të tierët, "paçin ndjesë"!


2.

Po lepuri aspak mendjen s'e vrau
Dhe iku, nuk e pa hatanë që ngriau.

Luani dinte ç'bënte: zuri pritë
Atje ku kafshët pinin ujë përditë.

Të shkojmë - tha dreri - se luani fle,
Si vështroi portretin gjatë e me nge.

Dhe kafshët nisën udhën me varganë
Të tradhëtuarë, në pritë të bishës ranë,
Medet pylli i blertë u krodh në zi
Dhe lepuri e mallkoi veprën e tij.



Dosje e dhelprës

Kur dosjen dhelprës ia hapën
Bishtkuqja ngriu, u ndodh ngushtë.
I thanë: - Trezo sa herë të kapën
Me pula, a në vreshtë me rrush?

E ndodhur shpesh në udhëkryq
S'e humbte ndrikulla ndër gjyq
Dhe ja, si u mendua ca
E gjeti befaz prapë një vah:
- Uërtet kam viedhur - tha - jo rrallë
Por për këtë unë duhem lavdëruar:
(Natyrisht në këndvështrim social)
Më shumë kam ndihur se dëmtuar.
Unë kurrë në jetë, nuk e kam mbrojtur
Kooperativën e dështuar...

Domethënë ishte seç na ishte
Dhelpra - heroinë e punës kapitaliste...

Kritika e urithit

Kur flutura poete
Botoi librin e parë
I ftoi miqtë e saj
Në një tubim letrar.

- Vërtet i mrekullueshëm
Ky libër, - foli pata, -
Çdo varë fsheh aq freski
Aq ngjyra e penelata!

- Çdo ndjenjë, - tha karkaleci, -
Buron si gurrë e pastër,
- Më duket i figurshëm
- Tha pilivesa e kaltër.

Kështu, me radhë insektet
Dhe zogjtë e lëvduan,
Në fund, si hëngrën kekun
U ngritën edhe shkuan.

Por ç'ndodhi ditën tjetër?
Gëzimi cazë u fik
Sepse urith kopshtari
Kish shkruar një kritikë:



- I bukur është ky libër
Plot fllad e fluturime
Por jetën s'e njih mirë
Kur s'flet për zuvën time: "

Se lulët faqe dielli
I kanë rrënjët nën tokë
Ndaj po s'punoj beli
Shkoinë metaforat kot.

Maçoku deputet dhe shtetrrëthimi

1.

Kur morën vesh
Minitë e kanaleve
Se deputet për ta ishte maçoku.
E bojkotuan fushatën elektorale.
- Protestojmë, - tha miu plak.
- Mes nesh s'ka mirëkuptim.
Por gjak:
Ne s'duam diktator
Por një plebishit popullor
Ku të shpallim republikën
Dhe askujt
Mos t'ia kemi më frikën.

2.

Brohoritën minitë
Sa jehoi zëri së largu:
- Poshtë Maçoku dhe Çarku!
Si rrjedhojë
Pas këtij tubimi
U linçua çdo qendër votimi:
Në çdo fasadë
Ku vend peneli gjeti
Me mlllef u shkrua
- Poshtë deputeti!
Ndërsa fotografitë e tij

U dogjën me ceremoni.

3.

Dëgjoi maçoku


Plot inat u ndez

Dhe tha: - ç'mosmirënjohje e zezë!

Ndaj që të heqin dorë

Nga rebelimi, fushata shtyhet

Shpallet shtetrrëthimi!



Firma “Mjau - Mjau”

Pas një viti asistence
Në të zymtin tranzicion
Zu maçokut që t'i ecte
Me tregti bleu furgon.

Por paraia zu të shtohet
Dhe çka pritej ajo ngjau.
Nga furgoni, pas ca kohe
Lindi firma “Mjau - mjau”.

Qeni, derri dhe kaprolli
Mbetën shtangur të çuditur.
- Të ka faj? - u hodh ariu. -
Shih sa lart është ngjitur!

Dhe gjithë kohën me ankesa
Lumëdhenitë s'gjenin karar.
Nuk kuptonin se ish koha
Për t'u vënë dhe ata në garë.

Mjelma dhe Lauresha Topmodele

Në sallonin e modës
Ku top modelet
Ueshjet ekspozonin,
Lauresha e mjelma
Për çudi mungonin.
Mungesa po shkaktonte ethe
Sepse dy vajzat
Ishin pretendente
Ndërkaq më e madhe
U bë çudia
Se s'dinin gjë as nga shtëpia:
Meqë askush s'jepte shpjegime
Në skenë vazhdohej
Me improvizime
Dhe interpretoheshin numra të tjerë
Derisa punës i ra erë
Ndaj për rrjedhojë plasi paniku
(Sepse në sallë
Ish ftuar dhe publiku).

2.

U shtang prezentatori
Memecë u bënë të anketuarit.
Por gazetarët ishin të fituarit
Ndaj rendën ta peshkoinë
Këtë ngjarje

Që mund t'u sillte nesër honorare
Ndërkaq nën valle dritash
Plot tërbim.
(Intriguese si në dramën e Shekspirit)
Buçiti telefoni anonim:
Dhe plot sarkazëm një zë thirri
- Ju flet rrëmbyesi
Me kulturë e gjuhë konsesusi:
Dërgomëni sa më parë
Dhjetmijë dollarë.
Sepse përndryshe
Për Mjelmën e Lareshën
Do qajnë përgjithmonë
Ata që i deshën.

Gjigandomania

Kur pa se arat jo rentabël
Me shkurre u mbushën përsëri
Tha ujku: - ç'vuajtje na sollë
Dhe ne, kjo gjigandomani!

*Në maja malesh me dëborë
U ngjitëm, hoqëm shumë murtane
Më kot barinjtë i mbanin qentë
Ne s'mund të qaseshim në stane.*

- U xhvesh krejt trualli - tha ariu. -
Çudi pa pyll si rrojtëm vallë?
- Ah, ajo dihet - vazhdoi ujku. -
Kemi rrojtur veç me... bar!

Miu dhe maçoku në një varkë

Mbi varkën e braktisur
Lundronin të dy tok,
Për t'i shpëtuar mbyties
Një mi dhe një maçok.

Nga brezu kur i shihnin
Habiteshin me ta,
Por ja, së fundi rryma
I shpuri tek një vah.

Kur panë se shkoi rreziku
Dhe rërës varka mbeti
U shua midis tyre
Krejt solidariteti.

Dhe për pasojë, në tokë
Zbarkoi një pasagjer,
Por s'mund të akuzohej dot
Lumi, këtë herë.

Ryshfeti

1.

Meqë s'kish ngrënë dot,
Rrush në vreshta,
Uendosi dhelpra të testohej
Kur erdhi vieshta,
Që Lafonteni të pendohej
Dhe mos ta ngiste më
Kurrën e kurrës
Në sferën e frutikulturës.

2.

U shtang mësues ariu
Dhe një dyshim i vetëtiu
- S'kuptoj, - tha, -
Se ç'kërkon moj punëthatë
Ti rrushin e ke mbajtur
Për të thartë,
Duke përçmuar bujqit që punonin,
Ciklet e pjekjes
Dhe vezjetacionin.


3.

- Ashtu vërtet, - ia priti dhelpra -
Po ecën (3).
S'mbetet pa jeta:
Ndaj që ta ndreq këtë gabim

Sot erdha në provim.
Dhe (mbushur plot raki)
Një damixhanë.
Ia vu mbi putër ariut babaxhan.

4.

U gajax ariu, - ha - ha - ha.
Aq sa përshtyma iu tha:
- Moj ndrikull - e qortoi
A je në vete?
Uallë. mundet Lafonteni me rryshfete?



“Rinovimi” i ujkut

· Besoi - tha ujkut
· Se demokracia
S' do t' më gijkojë
Nga biografia.

Ç'u bë gjer die, në stan
Qofshin të shkuara.
Sot rrojmë në paqe
Ditë të gëzuara.

Por meqë s' më pëlqen
Të rri pa punë.
Bari do bëhem
Me kërrabë e gënë.

Që stani të ketë rast
Për të kuptuar
Se jam vërtet
Një ujk “i rinovuar”.

Klimë politike

Në kongresin e dhjetë
Të fruta - perimeve
(Me delegatë të gjelbër nga gjithë bota)
Përpara auditorit referuan
Banania, preshi,
Qepa dhe karrota.
E natyrisht do të vazhdonim gjatë,
Me këta delegatë
Po t'i portretizonim...
Por ne do të veçonim
Bisedat mbi florën tonë.
Për të cilat,
Korrespondentja luleshtrydhe
Informon:

“U pyet konkretisht
Për vreshtat e Lukovës,
Ullijtë e Beratit
Dhe gështenjat e Tropojës:
Përgjigja jonë
(E prerë dhe patetike)
S’prodhuan dot për shkaqe politike.

Kjo deklaratë
I intrigoi delegatët,
(Pati ilaritete, moskuptime)
Por shpejt kinooperator kastravec

Gjithçka e sgaroi bukur
Me filmin "Edhe koha ngeci".

Më pas foli sërish korrespondentia
Për DAP e agrobiznes
Për komplekse e superfosfat
Për privatizim të shpejt...

Ç'të shihje? delegatëve
U shkoi ndrydhja
Në kor ia patën: - rroftë luleshtrydhja!

Akuza e dhelprës

Me gjithëse putrën e kafshoi.
Siç thuhet se e ka zakon.
Nga çarku dhelpra nuk shpëtoi
Ndaj tjetër zgjidhje nis kërkon.

- Përse - tha - nuk më hiqni zvarrë?
Dhe kafshët zunë që ta tërheqin.
Disa me fshikuj fort i binin
- Tani - thanë - qejfin mirë ta ndresim!

Por shpejt zu dhelpra të ankohet
Se një polic nga prapa mbrritti:
- Uështro zotni - tha - si dhunohet
Këtu. liria e individit.

Miu kampion

(Nga eurovizioni)

1.

Pas ndeshjes dramatike
Me ariun
(Kur miu u shpall kampion!)
Masmedia e pyllit
U ra borive për korrupsion:
Dukej, pas marramendjes dhe shkëlqimit
Boksi ish sulur pas fitimit.
Pas basteve e surprizave
Për peshat e "elefantëve" e të "mizave"

2.

Çudia ndolli intervistat
Që mbushën gazetatat dhe revistat
Dha kamerat plot nostalgji
Kërkonin anekënd "Klejin e ri".
Po për çudi
Gjékundi s'dukej miu.
Nën blice buzëqeshte veç ariu:
Ku ish kampioni?
Përse s'intervistohej?
Publiku pak nga pak po nervozohej.

3.

Po kur lezjenda
Zu të shuhej fare

Përgjigja erdhi krejt protokollare.

(E errët, ekuivoke, plot siklet):

- Kampioni i ri nuk do publicitet.

(Aktualisht ka disa hematoma.

Por s'është në gjendje koma)

Ky star i vogël, deri die në hije

Në boks sot hap një faqe historie.

Me bindje e themi

(Vetë ringu e provoi)

Se çdo tabu e dieshme perëndoi.

4.

Po ndërsa sateliti transmetonte

Këtë koment paradoksal.

Gjithë prapaskenën do e zbulonte

Pas pak... ngordhja e miut në spital.

Ç'të shihje?

Si meteor lezjenda u shua

Dhe ndeshja historike u anulua.

Kudo shpërtheu zemërimi

Nga fyerja dhe zhgënjimi.

Ndërsa ari faqeziu.

Siç thuhej, deklaroi në hetuesi:

Në akord me bosët titullarë

E kishte shitur ndeshjen për dollarë.

Fiasko '95

(Nga euronvizioni)

Kur mori vesh për dhunë
Masakra e tmerre
Në pyllin e grindieve e të sherreve.
Këshilli botëror i faunës ngriu
Dhe i dënoi
Arinitë (e ardhur nga veriu).
Pa humbur kohë
Dërgoi trupa e mjete
(Kaska nga KBF dhe Unprofor)
Por shpejt flakët e luftës u përhapën
Në gjithë gadishullin jugperëndimor.

Kur panë se bota
Ua dënoi krimet
Arinitë kreshpëruan qimet:
U sulën mbi korrespondentët.
Linçuan misionarët.
Përzunë ndërmjetësit e parlamentarët
Dhe të pakënaqur nga ndërhyrja
Vendosën të bëhej e tyrja.
Në këtë kuadër
Maskim i bënë genocidit
Duke blufur për "lirinë e individit"
"Të drejtën historike" të mohuar
Në pyll për të sunduar

(Që s'ish veç pansllavizëm i kultuar).

Po reagimi u shtua:

Përveç armatës së gazetarëve

(Që qenë midis të parëve)

Pati protesta e indinjata

Nga institute bamirësie e shoqata:

U sollën ndihma

Nga urdhri i murgeshave

Gjysmëhëna e kuqe, Kryqi i Kuq

Ku shpesh dhuruesit vriteshin nga snajperët

Dhe pakot për viktimat shkonin huq.

Por ndonëse embargoja

Ish e motivuar

Dhe dënimi (moral) i merituar

Ish tepër kuptimplot si metaforë

Një thënie gazetari plot humor.

Se kjo fushatë kundër arinive

Ish si betejë e Don Kishotit

Ndaj mullinive

(Se s'mund të ish perfekte

Ndërhyrja indirekte)

Arinitë s'kishin frikë nga rezolutat

Sa kohë që askush

Nuk do t'ua shkulte putrat...

Kërmilli

Kërmilli i pyllit
(me rryshfet në dorë)
Kish marrë tek mjeku
Një raport mjeksor.

Dhe që mundimi
Kot mos t'i humbiste
U fsheh thellë në zërbonjë
E po gërhiste.

Ndërkaq nga flakët
Pema ish pushtuar
Ngado u sulën fqinjët
Të alarmuar.

Por si përgjigje
U dëgjua ankimi
- Më lini që të fle
Kam ditë pushimi!

Revanshi i korbit

Bilbili i papunë

Që rronte hollë - hollë

Një ditë shkoi te korbi

Që i shkonin punët fjollë.

- E di, - tha, - s'më ke dashur

Për shkak të këngës sime

Por sot, në tranzicion

S'ushqehem dot me çmime:

Ti afarist u bëre

Afromë fë lutem punë.

Tha korbi: - në të shkuarën

Shumë më ke lënduar

Më e drejtë ish të dëboja

Por s'më bën goja

Megjithëse ti s'më çmon

Këtu, e keqja të mbron,

Po mund të ndreqen ca gjëra

Në do që të kesh ushqim me vlera

Nga sot që prapa skene

Do të jesh dublanti im pa cene:

Uërtet talenti yt

S'mund të kalojë tek mua

Por kjo s'është rëndësi

Do të kem famën që dua!

Dyfytyrësia e mjelmës

E bukura mjelmë pendëbardhë
(Që shpesh e thërrisnin perri)
Kish dy kavaljerë sqimatarë
Pëllumbin dhe korbin e zi.

Me ta shkonte shpesh të dëfrehej
Në bar-restorante, motele,
veç fjalën askujt nuk ja jepte
Me gjithëse u sillej plot ledhe.

Por ja, u mbaruan paratë
Në hall mbetën dy kavaljerët
Tha mjelma: - medet, s'paski fat
Po shkoj se më presin të tjerët.

Gropa e “Oktapodit”


(Më qafsh moj shegë se ngeli plënci varur!)

Kur u shpall lajmërimi
Se do të ndërtohej hotel “Blerimi”
Investorëve në pyll
Papritur dera iu mbyll
Çfarë ndodhi?
Kontratën e firmosi “Oktapodhi”
Një firmë e huaj
Krejt enigmatike
Siç shprehej media në mënyrë kritike.

Ndërkaq pas disa ditësh euforie
U vu gjithçka
Në pikëpyetje e hije:
Projekti u nda!
Për shkakë krejt të errëta
Dhe kjo shkaktoi
Akuza të ndërsjellta.

Ç’ndodhi më pas?
Kontrata u shfuqizua
Se firma për skandal u akuzua.
Punimet u braktisën.
Dhe shpejt hetimet nisën:
Kështu kjo punë

E thënë copë,
I hapi pyllit të pafajshëm
Një dosje dhe një gropë...



Majmuni, ariu dhe të tjerë

- Hej vëllezër, - tha majmuni
Pasi hipi majë një ledhi.
- Mbathjani të gjithë: në pyll
Sapo ra një copë dielli!

Rendën kafshët, rendën shpendët
Në panik dhe s'panë më prapa.
Se vërtetë pylli po digjej
Shkrumb qenë bërë banane e palma:

Por tek iknin fushës tutje
Hijerëndë u del ariu,
Me një bel të madh mbi supe
Plot inat u sokëlliu:

- More ç'bëni ku po shkoni?
Pylli diegur është nga vapa
Ju, në vend që ta shpëtoni
Ndiqni një mashtrues nga prapa!

Filozofi e gomarit

1.

Meqënëse i zgjuar deshte të tregohej

Gomari nisi të arsyetohej:

- Nga soji ynë

Ka pasur dhe me shkollë

(Siç thotë Nastradini mendjehollë)

Dhe unë jam nipi i atij gomari

Që ai ia mori një tregtari

Me kushtin që për njëzetë e ca vjet

T'ia kthente përsëri, me fakultet.

2.

I thanë: - këtë fabul të dëgjuar

Mjerisht o veshgjat

Sëprapthi e ke kuptuar.

Se Nastradini

(I varfër e në nevojë)

Tregtarin budalla vuri në lojë

Që pasurinë e vet

Humbi pa mend

Për "arsimimin" e stërgjyshit tënd...

Kusarët

Në një arë të huaj
Ku zverdhonin pjepra
Në terr u takuan
Lepuri dhe dhelpëra.

- Vazabond, - tha ndrikulla, -
Ke ardhur të vjedhësh.
Për dënim sot pjepërat
Duhet të m'i vjelësh.


- Eh, ç'të bësh, - tha lepuri
Dhe thellë psherëtiu
Më hiqesh kopshtare
Se po fle ariu.

Zilia

Kur vuri re pëllumbin
T'i shkonte pranë folesë
Përkrah me kanarinën
Me mlllef korbi u ndez.
- Ah ç'kam për të punuar
Ta dish o pendëshkruar:
Të gjithë do ta marrin vesh
Sot. Pabesinë tënde
Ndaj zoniës pëllumbeshë:
S'mund t'u bëj sfidë
Parimeve të mia
Ku rreptësisht
Ndalohet dashuria!

- Më fal o pëllumbeshë
Për shqetësimin.
Nga një qëllim fisnik
Mora mundimin
Të vij këtu për t'jua thënë aqic
Se burri juaj
S'është aspak besnik...
Por ndryshe nga parashikimi
Përgjigja s'qe që s'qe
Falënderimi.
- O korb. - tha pëllumbesha
Unë këtë nder s'ta desha:

Më bëjnë të qeshem
Këto fjalë që thua.
Pse s'sheh punët e tua?
Pranoje që je brejtur nga zilia
Ndaj s'ndan dot shoqërinë
Nga dashuria.



Një mësim në stan

Një ditë kur varej
Mjegulla tek shpati
Në stan, bariut
Iu qa veshgjati:

- S'kuptoj pse Balon
Ti e mban me hatër
Kur unë gjithë ditën
Dru mbaj sa për katër:

Por ja, në derë të vathës
Qeni lehu.
Përgjoi bariu
Klithma ujqish ndjeu...

- More gomar - tha -
- Ç'fshihesh pas mullarit?
U struk veshgjati:
- Të keqen e samarit!

Kaprolli martohet me sorkadhen e huaj

Kaprolli në kurbet të zi
Zu miqësi me një sorkadhe
Që ishte e bukur si perri
Por nazelie e sqimatare.
- Kaprollis - tha - të dua,
- Më merr gjineka mua.
Do jesh i lumtur fort
Nga dashuria
Dhe s' do të trembë më policia.
Ah, fort zemra më ndjeu
Për ty, që kur u duke nga Pireu
Harroje vendlindien bukurosh,
S' të lë të më shpëtosh!

Kështu një ditë
Kaprolli u dorëzua
Dhe me sorkadhen e huaj u kurorëzua
Tha nusja e re: - poli kalla,
Je tjetër tani, pedhja!
Na pret një muaj mjalti idilik
Në Rodos, në Athinë e Selanik!
Na presin plazhet, varkat, serenatat
Kazinat, rroku dhe portokalladat!
Ky vend ka dhe shumë antikitet
Që do të bëjnë sigurisht për vete,
Por veç ngulite fort

Në pasaportë je kaproll vorioepirot
Përndryshe kjo martesë është e kotë.

Mbeti kaprolli në mëdyshje
Por s'mundi dot të bënte ndryshe.
E kapërdiu tradhëtinë
Dhe zgjodhi turpin, arratinë:
Harroi atdheun në pak muaj
Në gjuhë e zakone na u bë i huaj.
La prindërit pas, në pikë të hallit
Flamur e zot paranë shpalli...

Mendja gjë e madhe, lumë e përdua,
Kaprolli me sorkadhen e huaj seç na u martua

Përmbajtja

Kioskat	3
Ankesa e gjinkallës	4
Pendimi i dhelprës "politikane"	5
Drejt Europës	6
Diskutim në parlamentin e pyllit	7
Urithi dhe serra	8
Kanarina bëhet prostitutë	9
Ariu refugjat	10
Ujku në Bosnjë	12
Gabimi i lepurit	14
Dosje e dhelprës	16
Kritika e urithit	17
Maçoku deputet dhe shtetrrrethimi	19
Firma "Mjau - Mjau"	21
Mjelma dhe Lauresha Topmodele	22
Gjigandomania	24
Miu dhe maçoku në një varkë	25
Ryshfeti	26
"Rinovimi" i ujkut	28
Klimë politike	29
Akuza e dhelprës	30
Miu kampion	31
Fiasko '95	33
Kërmilli	35
Revanshi i korbit	36
Dyfytyrësia e mjelmës	37
Gropa e "Oktapodit"	38
Majmuni, ariu dhe të tjerë	40
Filozofi e gomarit	41
Kusarët	42
Zilia	43
Një mësim në stan	45
Kaprolli martohet me sorkad'hen e huaj	46